



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 211, datë 10.06.2022

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT VLERËSUES DHE PROPOZIMIT TË GRUPIT
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS MBI RIORGANIZIMIN E RRETHEVE
GJYQËSORE DHE KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 61 në lidhje me nenin 84 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të tre anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Illir Rusi, znj.Marçela Shehu dhe znj.Brikena Ukperaj,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vlerësues përfundimtar të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e propozimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, si vijon :
 - 2.1 Riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga njëzetë e dy gjykata të rretheve gjyqësore në trembëdhjetë gjykata të tilla, me kompetenca tokësore si më poshtë:
 - i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Berat**, me seli në qytetin Berat dhe kompetencë tokësore në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan;
 - ii) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Dibër**, me seli në qytetin Peshkopi dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;
 - iii) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Durrës**, me seli në qytetin Durrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë;
 - iv) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Elbasan**, me seli në qytetin Elbasan dhe kompetencë tokësore në bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Përrenjas;
 - v) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Fier**, me seli në qytetin Fier dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë dhe Mallakastër;
 - vi) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Gjirokastër**, me seli në qytetin Gjirokastër dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastër, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;

- vii) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Lezhë**, me seli në qytetin Lezhë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;
- viii) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Korçë**, me seli në qytetin Korçë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec;
- ix) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Kukës**, me seli në qytetin Kukës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;
- x) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Sarandë**, me seli në qytetin Sarandë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë;
- xi) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Shkodër**, me seli në qytetin Shkodër dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz;
- xii) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Tiranë**, me seli në qytetin Tiranë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë dhe Krujë;
- xiii) Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Vlorë**, me seli në qytetin Vlorë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.

2.2 Riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga gjashtë gjykata apeli, në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin Tiranë.

2.3 Riorganizimin e gjykatave administrative të shkallës së parë, nga gjashtë gjykata administrative në dy gjykata të tilla, me kompetenca tokësore si më poshtë:

- i) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin Tiranë dhe kompetencë tokësore që përfshin rrethet gjyqësore, Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.
- ii) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje, me seli në qytetin Lushnje dhe kompetencë tokësore që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastër, Sarandë dhe Vlorë.

3. Përcjelljen e raportit vlerësues përfundimtar dhe propozimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor tek Ministri i Drejtësisë, për të vijuar me marrjen e mendimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR